



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN/ OSNOVNI SUD U PRIZRENU/ BASIC COURT IN PRIZREN

---

**Cnr.751/12**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** në përbërje nga gjyqtari Shaban Shala, me sekretaren juridike Luljeta Susuri, në çështjen juridike të paditësit A. H. nga Prizreni të cilin me autorizim e përfaqëson av. N. Q. nga Prizreni, kundër të paditurës KEK-ut në Prishtinë, lidhur me anulimin e vendimit dhe kthimin në vendin e punës, në prezencën e paditësit dhe të autorizuarit të tij, si dhe të autorizuarit të paditurës me dt.22.10.2012, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit A. H. nga Prizreni, ashtu që anulohet vendimi i të paditurit KEK-ut Sh.a. – Divizioni i Rrjetit Prishtinë me nr.../.. i datës ... dhe vendimi me nr... i datës ... për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

**II. OBLIGOHET** e paditura që paditësin ta kthej në vendin e punës të cilin e ka ushtruar si specialist i daljeve duke ia njohur të gjitha të drejtat nga vendi i punës dhe t'ia kompensoj të ardhurat personale nga vendi i punës sipas kontratës në lartësinë prej 400 € bruto në muaj duke filluar nga data 08.07.2012 deri në kthimin në punë me kamat ligjore prej 3.5 % nga dita e parashtrimit të padisë nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

**III.** Me shpenzimet procedurale në shumën prej 452 € obligohet e paditura.

**A r s y e t i m**

Paditësi në këtë gjykatë ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar që e paditura të anulon vendimin e saj nr. .../.. të datës ... dhe vendimin me nr... të datës ... për shkëputjen e marrëdhënies së punës, duke kërkuar kthimin në punë dhe kompensimin e të ardhurave personale për periudhën nga data 08.07.2012 deri në ekzekutimin e këtij

aktgjykimi në lartësi sipas të ardhurave personale nga vendi i punës ku punon duke llogaritur edhe kamatën ligjore që nga dita e parashtrimit të padisë nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm. Padiësi nëpërmjet të autorizuarit të tij av. N. Q. në shqyrtimet e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar: mbetet në tërësi si në padi dhe kërkesëpadi duke i propozuar gjykatës që të administrohen provat të cilat ia ka bashkangjitur padisë dhe dëgjimin e dëshmitarëve I. P., B. B. dhe A. K., ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor është vërtetuar se kërkesëpadija e padiësit është e bazuar për këto arsye se vendimet gjegjësisht njoftimet për shkëputjen e kontratës në mënyrë të njëanshme nga e paditura janë të paligjshme për faktin se nuk është vërtetuar shkelja e detyrave të punës dhe se e paditura nuk i ka respektuar procedurat ligjore siç është përcaktuar me Kodin disiplinor nr.2 dhe atë nenin 10 duke i përfshirë edhe paragrafët e këtij neni. Gjithashtu është evidente dhe është vërtetuar se padiësit i është shqiptuar masa disiplinore për shkak të performancës grupore çka paraqet diskriminim të drejtave dhe lirive të punëtorit nga se është parim që secili përgjigjet për veprimet e tija personale e jo të grupit. Sa i përket vërejtjes me shkrim të paditurës konsideroi se e njëjta është nxjerrë në kundërshtim me kodin disiplinor nga se punëtori vërejtjen e parë e ka marrë pa kaluar tre muaj në punë. E që nga kjo vërtetohet se nuk është respektuar kushti ligjor që duhet të ekzistojnë dy vërejtje paraprake me shkrim para se të shkëputet kontrata e punës e të gjitha këto në afat 2 (dy) vjeçar në të kundërtën vërejtja me shkrim nuk mund të prodhoi efekt juridik. Nga të gjitha këto i ka propozuar gjykatës që të aprovoi si të bazuar kërkesëpadiinë ashtu që vendimet e të paditurës të anulohen, padiësin ta kthej në vendin e punës sipas kontratës duke ia njohur të gjitha të drejtat nga vendi i punës si dhe t'ia kompensoi të ardhurat personale nga data 08.07.2012 deri në skadimin e kontratës me datën 31.12.2012. I ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale në shumën prej 452 € dhe atë në emër të përpilimit të padisë 80 € dhe për tri seancat e mbajtura nga 124 €.

I autorizuari i të paditurës në përgjigjen e dhënë në padi, në shqyrtimet e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar kërkesëpadiinë si të pabazuar për këto shkaqe se kërkesëpadija e padiësit që të kthehet në vendin e mëparshëm të punës është kërkesë e pa lëndë për shkak se padiësi me të paditurën ka pasur të lidhur kontratën e punës në kohë të caktuar, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me administrimin e provave në shqyrtimin kryesor e posaçërisht me dëgjimin e dëshmitarëve është vërtetuar se padiësi ka bërë shkelje të detyrave të punës për të cilin i padituri duke u bazuar në vërejtjet e fundit me shkrim nr... e datës ... padiësit i është bërë me dije se çdo shkelje tjetër apo çdo rast tjetër i rezultateve të pa kënaqshme në punë do të përbëjnë bazën për shkëputjen e kontratës së punës . Se performanca e padiësit ka qenë vërtet e dobët dëshmohet nga pasqyrat të cilat gjenden në shkresat e lëndës e sidomos nëse me vëmendje shikohet rubrika e humbjeve komerciale çka do të thotë se padiësit dhe kolegëve të tij energjia elektrike i

është vjedh nga konsumatorët diku për 1/3 të energjisë së konsumuar. Nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor më qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejt të gjendjes faktike ka administruar këto prova: ka bërë dëgjimin e dëshmitarëve I. P., B. B. dhe A. K., ka bërë leximin e vendimit nr.../.. i datës ..., ka bërë leximin e kërkesës për rishqyrtimin e vendimit nr... i datës ..., ka bërë leximin e vendimit të menaxherit të distriktit nr... i datës ..., ka bërë shikimin e performancave të datave 03.05.2012, 02.04.2012, 02.03.2012 dhe 03.02.2012, ka bërë leximin e ankesës të nënshkruar nga aktivistët e disa fshatrave, ka bërë leximin e kartelës së paditësit A. H., ka bërë leximin e vërejtjes së fundit me shkrim nr... e datës ..., ka bërë leximin e procesverbalit nr.../.. i datës ..., ka bërë leximin e ftesës për takim e datës 14.03.2011, ka bërë shikimin dhe leximin e kodit disiplinor nr.2, dhe ka bërë leximin e kontratës së punës të paditësit nr.../.. dhe pas vlerësimit të këtyre provave në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit duke aprovuar kërkesë padinë e paditësit si të bazuar pasi ka vërtetuar gjendjen faktike si më poshtë:

Nga dëgjimi i dëshmitarit I. P. i cili në pyetjet e të autorizuarve të palëve deklaron: se vendi i tij i punës është Menaxher i Departamentit për marrëdhënie me punëtor, ndërsa detyrat e tija janë të lidhura me procedurën disiplinore duke aranzhuar të gjitha shërbimet administrative në bazë të nenit 8.3 dhe 8.4 të Rregullores për Operime në Distrikte, sa i përket përgjegjësisë deklaron se përgjegjësia është individuale edhe pse shkeljet mund të jenë të përbashkëta kur punohet në ekip, sa i përket rasteve kur ndonjëri nga punëtorët mungon në punë si pjesë e ekipit për shkak se gjendet në pushim apo diçka tjetër ky punëtor nuk i nënshtrohet performancës për atë periudhë kohore, po ashtu shton se shqiptimi i masës disiplinore parashkruhet në afat prej 2 ( dy) viteve nga dita e shqiptimit dhe deklaron se Rregulloret që kanë qenë në fuqi në kohën kur paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës kanë qenë në harmoni me ligjin themelor të punës të aplikueshëm. Nga kjo deklaratë gjykata vërteton faktin se dëshmitari ka qenë dhe është në marrëdhënie pune të i padituri në cilësinë e Menaxherit të Departamentit për marrëdhënie me punëtorë, ndërsa në raport me çështjen kontestuese nuk vërteton asgjë me rëndësi për shkak se dëshmitari nuk ka marrë pjesë në kurrfarë cilësie në procedurën disiplinore që është zhvilluar kundër këtu paditësit.

Nga dëgjimi i dëshmitarit B. B. i cili në pyetjet e të autorizuarve të palëve deklaron: se në kohën kur paditësit i është shkëputur marrëdhënia e punës ka qenë koordinator në Distriktin e Prizrenit, ndërsa paditësi ka qenë lexues në daljen e Velezhës, paditësi në punë ka qenë i rregullt, aktiv nga ana e konsumatorëve nuk ka pasur asnjë vërejtje. Punëtorët E. S., K. K., Xh. P., M. K. dhe M. K. të gjithë janë ende

në marrëdhënie pune, performanca e punuar për muajt shkurt, mars dhe prill e vitit 2012, është punuar si performancë e grupit për daljen e Velezhës ndërsa përgjegjësia është individuale. Dëshmitari shton se ky ekip e ka mbuluar edhe daljen tjetër të fshatit Korishë dhe se matja e energjisë së shpenzuar për këto dy dalje bëhet me njehsor të veçant dhe se paditësi asnjë herë nuk është ankuar për shkak se nuk ka pasur problem sa i përket leximit të orëve dhe shpërndarjes së faturave. Nga kjo deklaratë e dëshmitarit gjykata e vërteton faktin se paditësi ka punuar si lexues dhe shpërndarës i faturave për daljen e Velezhës e cila mbulon edhe fshatin Korishë dhe se performanca për muajt shkurt, mars dhe prill të vitit 2012 është punuar për grupin nga i cili vetëm paditësit i është shkëputur marrëdhënia e punës kurse anëtarët tjerë të grupit E. S., K. K., Xh. P., M. K. dhe M. K. janë ende në marrëdhënie pune.

Nga dëgjimi i dëshmitarit A. K. i cili në pyetjet e të autorizuarve të palëve deklaron: se në kohën kur paditësit i është shkëput marrëdhënia e punës ka qenë koordinator i nën distriktit të cilin pozicion e mban aktualisht. Punëtorët E. S., K. K., Xh. P., M. K. i dhe M. K. janë ende në marrëdhënie pune, performanca për muajt shkurt, mars dhe prill të vitit 2012 ka qenë për grupin dhe se nuk është i sigurt se ndonjëri nga anëtarët e grupit ka munguar për ndonjë arsye. Po ashtu deklaron se fshati Korishë dhe Velezhë kanë pika të veçanta matëse, dhe se gjatë punës në teren paditësi nuk ka paraqitur vështirësi lidhur me leximin dhe shpërndarjen e faturave. Nga kjo deklaratë e dëshmitarit gjykata e vërteton faktin se paditësi ka punuar si lexues dhe shpërndarës i faturave për daljen e Velezhës e cila mbulon dhe fshatin Korishë dhe se performanca për muajt shkurt, mars dhe prill të vitit 2012 është punuar për grupin nga i cili grup vetëm paditësit i është shkëputur marrëdhënia e punës. Ndërsa anëtarët e tjerë të grupit E. S., K. K., Xh. P., M. K. dhe M. K. i janë ende në marrëdhënie pune.

Nga leximi i vendimit nr.../.. i datës ..., gjykata e vërteton faktin se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datën 18.07.2012 për shkak të rezultateve të pa kënaqshme në punë sepse në muajin prill të vitit 2012 nuk e ka arritur performancën e caktuar në punë gjegjësisht nuk e ka përmirësuar atë.

Nga leximi i kërkesës për rishqyrtimin e vendimit nr... i datës ... gjykata e vërteton faktin se paditësi i pa kënaqur me vendimin nr.../.. i datës ... paraqet kërkesë për rishqyrtimin e vendimit Drejtorit Ekzekutiv të Rrjetit me arsyetimin se vendimi me të cilin i është ndërprerë marrëdhënia e punës është i pa ligjshëm dhe jo i drejt për shkak se paditësi ka pasur gjithmonë rezultate të mira në punë.

Nga leximi i vendimit të menaxherit të distriktit nr... i datës ..., gjykata vërteton faktin se kërkesa e paditësit për rishqyrtimin e njoftimit – vendimit të menaxherit të distriktit nr... i datës ... është refuzuar si i pabazuar, me arsyetim se paditësi nuk e ka

arritur performancën ku objektivi ka qenë 88%, por vetëm 53,54% edhe pse paraprakisht ka qenë i njoftuar.

Nga shikimi i performancave të datave 03.05.2012, 02.04.2012, 02.03.2012 dhe 03.02.2012, gjykata vërteton faktin se këto performanca do të thotë për muajt prill, mars, shkurt, janar të vitit 2012 është punuar në ekip ku përpos paditësit kanë marr pjesë dhe punëtorët E. S., K. K., Xh. P., M. K. dhe M. K. dhe se objektivat kanë qenë të vendosura për grupin.

Nga leximi i ankesës të nënshkruar nga aktivistet e disa fshatrave, gjykata njoftohet me një ankesë respektivisht kërkesë të aktivistëve të fshatrave Shpenadi dhe Velezhë të cilët shprehin pa kënaqësinë për shkak të largimit të paditësit nga puna me arsyetimin se ai ka qenë punëtor shumë i mirë dhe bashkëpunues.

Nga leximi i kartelës së paditësit A. H., gjykata vërteton faktin se paditësi ka qenë i punësuar në Distriktin e Prizrenit si specialist i daljeve, ka të kryer shkollën e mesme drejtimi elektroteknik, është trajnuar për menaxhimin e pikave matëse, është i martuar dhe ka gjashtë fëmijë prej tyre dy studente e tre nxënës .

Nga leximi i vërejtjes së fundit me shkrim nr... e datës ..., gjykata vërteton faktin se paditësit i është shqiptuar vërejtje me shkrim për shkak të mospërmbushjes së objektivave të punës konkretisht mosrealizimi i performancës për muajin shkurt 2011.

Nga leximi i procesverbalit nr.../.. i datës ..., gjykata vërteton faktin se paditësit në mbledhjen e mbajtur me datën 16.03.2011 e cila ka filluar nga ora 09,30 në të cilin kanë prezantuar menaxheri i distriktit V. S., paditësi, përfaqësuesi i sindikatës paditësit nga menaxheri i distriktit paditësit i është dorëzuar vërejtja e fundit me shkrim.

Nga leximi i ftesës për takim i datës 14.03.2011, gjykata vërteton faktin se në bazë të dispozitave ligjore paditësi është ftuar në takim me 16.03.2011, në ora 09,30 për tu njoftuar për mosrealizimin e performancës për muajin shkurt të vitit 2011.

Nga leximi i kontratës së punës të paditësit nr.../.. gjykata vërteton faktin se paditësi me të paditurin ka lidhur kontratë pune në kohë të caktuar duke filluar nga data 01.01.2012 deri më 31.12.2012 si specialist i daljeve me pagë mujore bruto në shumën prej 400 €.

Për gjykatën nuk është kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura që nga viti 2010 dhe në bazë të kontratës së fundit të punës ka krijuar marrëdhënie pune në kohë të caktuar se gjatë kësaj periudhe i janë shqiptuar masa disiplinore ky fakt vërtetohet pothuaj nga të gjitha provat të cilat janë administruar më lartë të cilat prova këtë fakt e vërtetojnë direkt apo indirekt.

Mirëpo mbetet kontestues fakti se paditësit e paditura a ia ka shkëputur kontratën e punës duke u bazuar në dispozita ligjore për shkak se për muajin prill të vitit 2012 nuk ka arritur performancën e caktuar për punë gjegjësisht nuk e ka përmirësuar atë dhe se më rastin e shkëputjes së kontratës së punës e paditura a ka respektuar procedurat ligjore me rastin e shkëputjes së kontratës së punës.

Se paditësit e paditura ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës pa u bazuar në dispozita ligjore respektivisht se në rastin konkret me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës e paditura ka bërë diskriminim kur vetëm paditësit nga i tërë ekipi i është ndërprerë marrëdhënia e punës lidhur me objektivat të cilat janë vendosur për tërë ekipin. Këtë fakt gjykata e vërteton nga dëshmia e dëshmitarëve B. B. dhe A. K. si dhe performancat e datave 03.05.2012, 02.04.2012, 02.03.2012 dhe 03.02.2012 të cilave prova gjykata ia fali plotësisht besimin nga të cilat vërtetohet se është punuar në ekip dhe se objektivat dhe performancat kanë të vendosura për tërë grupin.

Gjykata refuzoi pretendimet e të autorizuarit të paditësit se e paditura me rastin e shkëputjes së kontratës së punës nuk ka zbatuar dispozitat procedurale konkretisht ka shkelur nenin 10 të Kodit Disiplinor nr.2 dhe se vërejtja me shkrim i është shqiptuar pa kaluar 3 muaj pune për shkak se e paditura ka respektuar dispozitat ligjore pasi që ka ftuar paditësin në takim dhe se në bazë të ftesës është mbajtur takimi me paditësin ky fakt vërtetohet në bazë të procesverbalit nr.307/1 dhe ftesës për takim të cilave prova ia fali besimin, ndërsa pretendimi se paditësit i është shqiptuar masa disiplinore pa kaluar tre muaj dite pune po ashtu e refuzoi si të pa bazuar për shkak se vërejtja paditësit i është shqiptuar jo para, por pas kalimit të afatit tre mujor e kjo vërtetohet nga prova materiale kartela e punëtorit sipas së cilës vërtetohet se paditësi ka themeluar marrëdhënien e punës më datën 08.07.2010, ndërsa vërejtja i është shqiptuar më datën 13.12.2010 do të thotë pas tre muajve të cilës provë gjykata po ashtu ia fali besimin.

Duke u bazuar në këtë gjendje faktike se paditësit me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës ka pasur diskriminim për shkak se vetëm paditësit nga të gjithë anëtarët tjerë të grupit i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe se Ligji i Punës nr.03/L-212 konkretisht neni 5 i tij ndalon të gjitha format e diskriminimit duke përfshirë edhe ndërprerjen e kontratës së punës dhe duke u bazuar në nenin 80 par.1 pika 1.2 të këtij ligji i cili përcakton :” Se nëse largimi nga puna vlerësohet i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, gjykata mund të rikthejë të punësuarit në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë kohës së largimit të paligjshëm nga puna” gjykata ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit si të bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 452 të LPK-së.

Nga arsyerat e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Cnr.751/12 të dt.22.10.2013**

**Proçesmbajtësja**  
Luljeta Susuri

**Gjyqtari**  
Shaban Shala

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 (shtatë) dite nga dita e pranimit, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.